



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 24
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 24 shtator 2018, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Drita Millaku dhe Naser Rugova.

Të ftuar: Pleurat Sejdiu, kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës (OMK); Arianit Jakupi, kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK); Dafinë Ibrahim- Kaqiu, kryetare e Odës së Fiziotrisë dhe Fizioterapeutve të Kosovës (OFFK); Naim Rrustemi, kryetar i Odës së Infermierëve dhe Mamive (OIK).

Pjesëmarrës tjerë: Rrezart Halili, Naser Gjonbalaj, OMK; Arianit Jakupi, Dafinë Ibrahim- Kaqiu, OFFK; Naim Rrustemi, OIK dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërmarrjet sociale;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës;
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Takim me kryetarët e odave të profesionistëve shëndetësorë

Kryetarja, tha se të ftuar kanë qenë 5 kryetarë të odave, mirëpo kryetari i Odës së Stomatologëve nuk gjendet në Kosovë. Ajo ua dha fjalën të gjithë kryetarëve, sipas radhës, që të prezantojnë shkurtimisht punën e tyre, deri më tani.

Pleurat Sejdiu, tha se në kohën kur ai ka ardhur në krye të Odës së Mjekëve, kanë qenë vetëm disa rregullore gjysmake, nuk ka pasur anëtarësi dhe nuk ka pasur as financa. Në gjashtë muajt e parë kemi filluar me anëtarësimin, stabilizimin e kornizës ligjore dhe stabilizimin financiar. Ai tha se në fillim ka marrë informata që në Kosovë janë 2400 mjekë, por që tani janë 3480 mjekë të anëtarësuar dhe rreth 300 mjekë na mungojnë, pra nuk janë anëtarësuar sipas listave zgjedhore. Ai tha se kanë propozuar që 1% nga paga e tyre bazë, të shkojë për anëtarësinë. Po ashtu, tha se deri në fund të vitit do ta bëjmë një analizë rreth kësaj kuote. Ai tha gjithashtu se janë duke punuar dhe për edukimin e vazhdueshëm profesional. Kryetari foli edhe për caktimin e afateve për vazhdimin e licencimit dhe tha se janë duke u përforcuar mirë, në këtë aspekt.

Arianit Jakupi, tha se kanë bërë konsolidimin e organeve të odës. Sipas tij, është bërë një program 4 vjeçar për punën e mëtutjeshme. Ai tha se në Kosovë janë rreth 1000 farmacistë. Lista e farmacistëve është e qasshme në ueb faqe. Në afat rekord, janë pranuar në Federatën Ndërkombëtare të Farmacisë dhe presin përgjigje pozitive edhe nga Rrjeti i Farmacistëve Evropianë.

Dafina Ibrahim- Kaqiu, tha se është shumë sfidë puna e specializimeve. Më tej, tha se kanë disa probleme rreth anëtarësimeve, por që tani kanë rreth 700 anëtarë dhe është bërë pranimi në Konfederatën Botërore të Fizioterapeutëve, si dhe do të janë të pranishëm kongresin e radhës, me të drejta të plota. Ajo tha se mandati i prokurorit të Odës është i shkurtër dhe kjo duhet të ndryshohet.

Naser Rrustemi, tha se janë rreth 26000 anëtarë dhe sfidë kryesore e kanë edukimin e vazhdueshëm profesional. Procesi i licencimit është duke shkuar në rregull dhe janë duke punuar edhe për infermierët, të cilët janë të papunë, si dhe kanë një fond, i cili quhet Fondi i solidaritetit, për këtë çështje. Ai informoi deputetët që kanë rreth 12 të punësuar, si staf.

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, tha se oda është opozitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe se roli i odave është që t'i mbështesin profesionistët shëndetësorë. Më tej, tha se duhet të përkrahen profesionistët shëndetësorë, që një pjesë të specializimeve ta kryejnë jashtë vendit, mirëpo që këto mundësi të mos iu jepen gjithmonë mjekëve të njëjtë. Ajo tha se mjekët e rinj duhet t'i inkurajojnë, që ta kryejnë stazhin dhe duhet të dihet se kush mund të jetë mentor dhe kush jo.

Enver Hoti, pyeti përfaqësuesin e Odës së Mjekëve, nëse janë të vonuar në bartjen e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë. Ai, gjithashtu, tha se po vërehet një mungesë e mjekëve në institucionet shëndetësore, për shkak të specializimeve.

Time Kadrijaj, pyeti: Çka do të ndodhë me stafin që ndodhet në Ministrinë e Shëndetësisë, a do të bartet në oda? Ajo tha se ne mund të bëjmë një amendamentim të ligjit për të drejtat e mjekëve. Ajo pyeti gjithashtu se a po mbulohen barnatorët me nga një farmacist, ashtu siç kërkohet nga ligji.

Haxhi Avdyli, përshëndeti për punën e odave, ku edhe vetë është anëtar i odës. Ai pyeti: sa jeni të koordinuar me shoqatat profesionale dhe sa keni përkrahje financiare nga Ministria e Shëndetësisë? Ai tha se odat kanë qenë të heshtur ndaj dënimeve dhe suspendimeve që kanë ndodhur ndaj mjekëve.

Flora Brovina, tha se detyra jonë është të shikojmë se a po zbatohet ligji dhe a po funksionojnë odat. Ajo pyeti: A u janë bartur odave mjetet e licencimit? A ka mjekë të licencuar nga minoriteti serb?

Fikrim Damka, tha se nëse nuk ka një barazi në mes mjekëve në sektorin publik dhe atyre privat, sipas tij, kjo është një shkelje e ligjit. Ai falënderoi Odën e Infermierëve, që në Prizren kanë mundësuar edukimin profesional në gjuhën turke.

Bekim Haxhiu, tha se zbatimi i ligjit është me rëndësi dhe është e paraparë që 0.7% e buxhetit të shtetit të ndahet për hulumtime shkencore dhe këtu përfshihet edhe edukimi i vazhdueshëm profesional. Mirëpo, kjo asnjëherë nuk është respektuar. Ai tha se Ministria e Shëndetësisë nuk ka dashur t'i ndajë kompetencat në fushën e specializimeve dhe në këtë fushë ka pasur shumë keqpërdorime.

Kryetarja, tha se kanë pasur një kërkesë nga Oda e Farmacistëve, sa i përket mundësisë së pjesëmarrjes së tyre në Bordin për Sigurimeve Shëndetësore. Ajo pyeti rreth pagesës për anëtarësim, se pse u ndalet deputetëve, pasi nuk punojnë në klinika.

Pleurat Sejdiu, tha se institucionet shëndetësore janë të obliguar, që të kenë kodin buxhetor për edukimin profesional të punëtorëve të vet. Lidhur me mjetet me ministrinë, ai tha se janë në procedura gjyqësore. Më tej, theksoi se minoriteti serb është tërhequr nga oda, pas vrasjes së Oliver Ivanoviqit, ndërsa minoriteti turk është i përfaqësuar. Ai, gjithashtu, tha se rreth 80% e mjekëve të huaj janë duke punuar pa licencë dhe kjo është vepër penale. Lidhur me bartjen e punëtorëve, tha se ata kanë refuzuar të vijnë dhe se kanë vazhduar punën me punëtorë të tjerë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Kryetarja, tha se sot po shqyrtojmë raportin përfundimtar për Projektligjin për ndërmarrjet sociale. Të gjitha komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar, në këtë rast, Komisioni për Legjislacionin i ka dhënë disa vërejtje, mirëpo nuk ka dhënë propozime apo amendamente. Përveç vërejtjet për partitë politike, të tjerat janë vërejtje të pabaza.

Komisioni, pas diskutimeve, njëzëri, miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për ndërmarrjet sociale dhe nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet raporti përfundimtar për Projektligjin për ndërmarrjet sociale dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës

Kryetarja, tha se sot para nesh kemi për shqyrtim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës. Ne, të gjithë e dimë rëndësinë e kësaj marrëveshjeje, pasi që ka disa vite që është diskutuar për të.

Komisioni, pas diskutimeve, njëzëri, miratoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës dhe nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës dhe i njëjti procedohet në seancë, për ratifikim.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës

Kryetarja, tha se sot para nesh, po ashtu, kemi për shqyrtim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës. Po ashtu, edhe kjo marrëveshje është e rëndësisë së veçantë dhe ne si komision duhet ta përkrahim.

Komisioni, pas diskutimeve, njëzëri, miratoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës dhe nxori këtë:

V e n d i m

Miratohet projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës dhe i njëjti procedohet në seancë, për ratifikim.

6. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi që të premtën do të kenë një vizitë në SHSKUK, ku do të takohen me drejtorin e SHSKUK-së. Ndërsa, nesër kemi një ftesë nga Federata e Shëndetësisë, e cila do të organizojë një tryezë, ku do të diskutohet për Projektligjin për pagat.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU